



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS sh.a  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS sh.a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.

06-09-2024

6028

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, Kodin e punës së KEK Sh.a, si dhe në bazë të nenit 6- Shpallja e konkursit publik për personat me aftësi të kufizuara të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e konkursit në sektorin publik, KEK-u shpallë konkurs publik të mbyllur për plotësimin e vendeve të punës për personat me aftësi të kufizuara. Ky konkurs është pjesë e angazhimit tonë për të përmbushur kreteret ligjore që sigurojnë punësimin e barabartë andaj, UD Kryeshëfi Ekzekutiv i KEK-ut autorizon Drejtorin e Burimeve Njerëzore, më 06.09.2024 që të publikojë ofertën për pozitat e mëposhtme:

## KONKURS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

<b>Titulli i pozitës:</b>	<b>Teknik te elektroteknikes</b>
<b>Institucioni:</b>	Korporata Energjetike e Kosovës ( Divizioni i prodhimit te qymyrit, Termocentralin TCA dhe TCB)
<b>Numri i referencës:</b>	08-06.09.2024
<b>Tipi Akt Emërimit te punës:</b>	Sipas Ligjit të punës 03/L-2012 dhe UA nr. 01/2024 neni 6.
<b>Titulli i mbikëqyrësit</b>	I raporton prijësit të ekipit, koordinatorit, inxhinierit të kryerjes, inxhinierit përgjegjës, udhëheqësit të sektorit apo sipas nevojës edhe kryeinxhinierit
<b>Kohëzgjatja e kontratës:</b>	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
<b>Koeficienti-paga:</b>	676 euro
<b>Procedura e aplikimit:</b>	I jashtëm
<b>Numri i kërkuar:</b>	3
<b>Vendi i punës:</b>	Obiliq ( Divizionin e prodhimit te qymyrit, Termocentralin TCA dhe TCB)

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

**Bartësi i vendit të punës** punon sipas urdhërësave të cilat i shtron prijësi i ekipit dhe inxhinieri i kryerjes, përpunon dhe vizaton dokumentacionin e nevojshëm për meremetimin e makinave elektrike në Departamentin e Elektrikës/Mirëmbajtjes. Përgjigjet për kualitetin dhe kuantitetin e punës. Kryerja e punëve të mirëmbajtjes së pajisjeve të elektrikes sipas urdhërësës së punës së inxhinierit përgjegjës përmes prijësit të ekipit, inxhinierit të kryerjes dhe organizmit që bënë inxhinieri i kryerjes si dhe kryerja e punëve sipas mirëmbajtjes preventive.

Zbaton urdhëresat e punës nga udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe udhëheqësit tjerë në vijën organizative si dhe jep propozime për përmirësime të nevojshme në sistemin e Departamentit të Elektrikes/Mirëmbajtjes.

Sistemimi dhe ruajtja e dokumentacionit teknik për pajisjet në përgjegjësinë e vet.

Jep propozime për përmirësime të nevojshme në sistemin e elektrikes nën përgjegjësinë e vet duke përcjellë problematiken e përditshme.

Respektimi rigoroz i udhëzimeve për mirëmbajtje, që janë përgatitur nga teknologu përgjegjës në bazë të udhëzimeve nga prodhuesi i pajisjeve.

Respektimi i masave të sigurisë në punë që kërkohen në vendndodhje nga zyrtari i sigurisë.

Autorizimet: Te kërkojë ndihmë nga stafi udhëheqës apo edhe nga kolegët tjerë për zgjidhjen e problemeve specifike.

Raportimet: Drejtpërdrejt i raporton: prijësit të ekipit, koordinatorit, inxhinierit të kryerjes, inxhinierit përgjegjës, udhëheqësit të sektorit apo sipas nevojës edhe kryeinxhinierit.

**Bartësi i vendit të punës** i regjistron hyrjet në kartela ,e bën shlyerjen e kërkesave,e zavendëson depoistin për dhënje të materialit dhe punë të tjera sipas nevojës.

I plotëson hyrjet e pranimit të mallit dhe pjesëve reserve të makunerisë dhe pjesëve elektrike dhe MRRK-së.

I regjistron hyrjet në kartela. Bën barazimin e kartelave. Bën shlyerjen e kërkesave të materiali dhe pjesëve rezervë. Jep material në rast mungese të depoistit.Kryen edhe detyra tjera të dhëna nga menaxheri i Dep. apo eprorët tjerë sipas hirearkisë.

Të merret me mbledhje dhe azhurim të dhënave të prodhimit të energjisë elektrike dhe të gjitha shpenzimeve që janë të lidhura me këtë prodhim(njehsorët elektrik, njehsorët kohor etj.)

**Bartësi i vendit të punës** Merret me mbledhjen dhe azhurim të dhënave nga procesi teknologjik(parametra të ndryshme punuese nga stabilimentet) të përpunohen dhe azhurohen harxhimet e kemikaleve dhe lëndëve djegëse (mazutit) në raportet-ditore ;mujore dhe vjetore për Elektran.

I përgjigjet udhëheqësve të vet, menaxherit ; menaxherit të departamentit të Inxhinjeringut; inxhinierit kryesor dhe inxhinierit përgjegjës

Zbaton urdhëresat e punës nga inxhinieri kryesor dhe inxhinieri përgjegjës.

Është autoritet i lart në domenin e punës dhe përgjegjësisë së vetë

Të kërkojë ndihmë nga inxhinierit kryesor dhe inxhinierit përgjegjës për zgjedhjen e problemeve specifike.

Vartësit e Drejtpërdrejtë: Bashkëpunon me inxhinierin e kryerjes si dhe inxhinierin përgjegjës si dhe personelin tjetër në grupin përkatës.

### Kriteret e përgjithshme dhe te veqanta per vendin e punës

Njohuri te mira ne përdorimin e kompjuterit

Aftesi te mira komunikimi ne gjuhen shqipe

Dokumentin qe vërteton aftesin e kufizuar ( qertifikaten mjksore)

Përvojen e me pareshme të punës nëse ka ( e preferushme)

Kopjen e diplomës së shkollës së mesme Elektroteknike

**Konkursi i mbyllur për personat me aftësi te kufizuar**

Konkursi është hapur vetëm për personat me aftësi te kufizuar, ashtu që vendi i punës për të cilin aplikon nuk e rrezikon shëndetin i tij.

**Dokumentet e kërkuara :**

Qertifiata që dëshmon aftësinë e kufizuar  
Kopje e diplomës së shkollës së mesme Elektroteknike  
Dokumentin që vërteton përvojën e punës dhe  
Një dokument identifikimi ( letërnjoftimin)

**Mënyra e aplikimit për tri pozitë : Aplikimi është në adresën elektronike : ofertapune@kek-energy.com. Duhet të hyni në ueb faqen e KEK-ut dhe ta shkarkoni aplikacionin e plotësoni dhe e dërgoni bashk me diplomën e shkollës së mesme ( Drejtimi Elektroteknik), Qertifikatën që dëshmon se jeni me aftësi te kufizuara, një mjet identifikues ( letërnjoftimin) si dhe përvojë pune nëse keni.**

**Njoftimi me rezultatin e konkursit publik :** Lista e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet për praninë do të shpallen në tabelën e shpalljes në KEK, por kandidatët individualisht do të njoftohen me rezultatin e këtij konkursi duke e respektuar Udhëzimin administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e konkursit në sektorin publik.

**Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve:** Jetepërshkrimi (CV) vlerësohet deri në tridhjetë (30) pikë. Intervista me gojë vlerësohet 70 pikë . Intervistimi i kandidatëve do të monitorohet me kamerë me qëllim të transparencës

**Vërejtje**

Aplikacionet pas afatit nuk do të pranohen, ndërsa ato të mangëta ose që nuk janë në formatin e kërkuar më lartë do të refuzohen. Kandidati i suksesshëm do të sistemohet në pozitën për të cilën ka aplikuar sipas kësaj shpalljeje dhe në afatin prej 3 (tre) viteve nga dita e kontratës së parë nuk ka të drejtë ri-sistemimi në vend tjetër të punës, përveç në raste të jashtëzakonshme me lejin e KE të KEK. Kalendar i përafërt: 25 dite intervistat me gojë dhe njoftimi final brenda 30 dite nëse nuk ka ankësë të cilat e pezullojnë afatin e paraparë sipas UA01/2024.

Data e aplikimit deri më 23.09.2024 ora 16:00

Prishtinë, 06.09.2024

